



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNES MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVA-SKUPSTINA OPSTINE MALISHEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 05/12/2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01/1999



Komuna e Malishevës
Municipality of Malisheva

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Datë: 5 dhjetor 2022

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Republikën e Kosovës, (Ligji nr.03/L-040), neni 4 par. 4.2, 4.3 dhe 4.4, neni 10 dhe 68 par. 68.1 dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës, Kryetari i Komunës fton:

DISKUTIMIN E DYTË PUBLIK ME QYTETARË PËR VITIN 2022

Diskutimi i dytë publik me qytetarë, do të mbahet të **premtën, më 23 dhjetor 2022, ora 11:00**, në Sallën e Kuvendit Komunal

Temat e diskutimit:

- Informimi i qytetarëve në lidhje me projektet e realizuara gjatë vitit 2022, si dhe për projektet që janë në proces të realizimit.
- Diskutim për çështje të ndryshme me interes për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Të gjithë qytetarët që kanë pyetje rreth këtij diskutimi publik, mund t'i dërgojnë në e-mailin zyrtar të Komunës; komuna.malisheve@rks-gov.net

Me respekt,

EKREM KASTRATI

Kryetar i Komunës së Malishevës



REPUBLIKA E MALISHEVËS



KOMUNA E MALISHEVËS

NJËSIA E KOMUNIKIMIT PUBLIK

Procesverbal nga takimin e dytë publik me qytetarë për vitin 2022, i Kryetarit Kastrati që u mbajt , më 23 dhjetor 2022, ora 11''

DISKUTIMI I DYTË PUBLIK ME QYTETARË PËR VITIN 2022

RENDI I DITËS

1. Informimi i qytetarëve në lidhje me projektet e realizuara gjatë vitit 2022, si dhe për projektet që janë në proces të realizimit.
2. Diskutim për çështje të ndryshme me interes për qytetarët e Komunës së Malishevës.



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve në raport me qytetarët, sot e ka mbajtur takimin e dytë publik me qytetarë, ku e ka prezantuar punën, të arriturat dhe aktivitetet e qeverisë komunale, gjatë vitit 2022. Më pas ka bashkëbiseduar me qytetarët për çështje të ndryshme me interes për qytetarët dhe komunën.

Kryetari Kastrati, fillimisht i ka njoftuar të pranishmit me realizimin e projekteve në Komunën e Malishevës dhe angazhimet e tij dhe të qeverisë komunale, në realizimin e projektit madhor për “Malishevën Urbane”, për çka edhe e ka marrë besimin e qytetarëve, pastaj investimet tjera në fshatra, në bujqësi, dhënien e subvencioneve në fusha të ndryshme, bursa për 316 student dhe shumë projekte tjera që lidhen me jetesën dhe mirëqenien e banorëve të Komunës së Malishevës.

Pas prezantimit të të arriturave dhe angazhimeve të qeverisë komunale, për zhvillimin e Komunës së Malishevës, Kryetari Kastrati ka biseduar me të pranishmit, për çështje tjera me rëndësi dhe interes për qytetarët, fshatrat dhe komunën në përgjithësi, si dhe është përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara nga të pranishmit.

Pa dyshim që, një nga preokupimet e mia gjatë këtij viti të qeverisjes ka qenë edhe zgjidhja e çështjes së ujit të pijes për gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.

Ne si qeverisje e kemi marrë shumë me seriozitet këtë çështje, dhe që në start të mandatit tonë kemi filluar të zhvillojmë takime me të gjithë akterët e mundshëm vendor e ndërkombëtar. Po ashtu, siç e dini në kemi vënë kontakte me një nga organizatat më të fuqishme austriake “OSTAP”, të cilët na kanë përkrah në realizimin e një projekti ideor për zgjidhjen e çështjes së ujit, të cilët bashkë me stafin tonë komunal kanë dalë për disa muaj rresht në teren, kanë bërë matje dhe analiza të shumta për tu kyçur në Ujësjiellësin e Radoniqit. E kemi finalizuar si dokument, pastaj në bashkëpunim me ta edhe e kemi adresuar një kërkesë në Qeveri të Kosovës, për të na dhënë një përkrahje procedurale, që në si Komunë të merrnim një financim kaq të madh nga Austriakët, mirëpo deri më tani nuk jemi duke marrë përgjigje nga Qeveria.

Si rezultat i gjithë këtij angazhimi tonë, Këshilli Ndërmintor për Ujëra, që drejtohet nga kryeministri, ka marrë vendim që të formohen grupet punuese për gjetjen e zgjidhjeve për furnizim me ujë nëpër komuna.

Lidhur me aktivitetet e shumta që janë realizuar përmes drejtorive tona përkatëse, me lejoni që të përmend vetëm disa nga më kryesorët:

- Kam nënshkruar kontratën për projektin ideor më madhor në historinë e Komunës sonë, pra projekti i Sheshit të Dëshmorëve, një projekt i jashtëzakonshëm që për qëllim ka Urbanizimin e qytetit. Ky projekt tashmë është në procedura të tenderimit (përshkrim i projektit)
- Kemi nisur jetësimin e projektit për rregullimin e rrugës kryesore “Ibrahim Mazreku”, nga ura e madhe deri tek transiti i shkollës profesionale ku është duke u realizuar. Faza e parë e infrastrukturës nëntokësore, ujërave fekale dhe atmosferike thuajse ka përfunduar, ndërsa faza e dytë pritet të nis sapo të krijohen kushtet për punë, ku planifikohet të zgjerohet rruga dhe gjithë infrastruktura nëntokësore, duke përfshirë këtu edhe sistemin elektrik dhe atë të internetit.
- Kemi nisur rregullimin e garazheve dhe rrethojës në shtëpinë e shëndetit “Shpëtim Robaj” në Malishevë ku si projekt është duke u implementuar.
- Është finalizuar ndërtimi i dy Çerdheve, në Malishevë dhe në Kijevë (Në Malishevë do të përurohet shumë shpejt, ndërsa në Kijevë është e përfunduar veç kemi pasur problem me stafin, të cilin nuk e ka aprovuar ministria për vitin aktual, ndërsa e ka paraparë për vitin 2023, dhe ne veç kemi filluar të marrim masat e duhura në mënyrë që çerdhja në Kijevë të hapet në fillimin e vitit që po hymë.

- Kemi filluar ndërtimin e pjesës lindore të tribunës në stadiumin Liman Gegaj, si dhe zhveshtoreve që parashihet të jenë me standarde ndërkombëtare.
- Kemi ndërtuar mbi 21 km trotuare dhe kemi asfaltuar rrugica në më shumë se 16 fshatra
- Kemi ndërtuar shumë rrugëve fushore dhe shtrimi i tyre është bërë me zhavorr
- Është duke u punuar në riparimin dhe zgjerimin e rrugës së minitransitit, ku parashihet edhe digjitalizimi i zonës së udhëkryqit.

Duhet theksuar se, gjatë këtij viti kemi nënshkruar edhe disa kontrata të rëndësishme, ku disa janë 3 vjeçare, si:

- Mirëmbajtje e rrugëve gjatë sezonës së verës dhe dimrit, ku këtu përfshihet edhe pastrimi i lumenjve sipas nevojës,
- Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik
- Renovimi i objekteve shkollore, etj.

Vlen të përmendet edhe implementimi i programit të efqiçences në katër objektet publike; shtëpia e kulturës “TahirSinani”, shkolla e mesme “Hamdi Berisha”, qendra kryesore familjare “ShpetimRobaj”, objekti i Komunës dhe shkolla e mesme në Kijevë i financuar nga fondi i efqiçnces Kosovare ku deri tani janë në përfundim e sipër.

Lajm me rëndësi për qytetarët e komunës sonë gjatë këtij viti, ishte edhe hapja e drejtimeve të reja në IAAP “ LasgushPoradeci” në Kijevë dhe ato drejtime janë:

- Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë;
- Teknik i Sistemeve të TIK;
- Zhvillues i aplikacioneve softuerike;
- Asistent Restoranti.

Po ashtu,

- Kemi ndarë bursa për mbi 316 studentë të Komunës së Malishevës, që kanë marrë bursë në vlerë 300 euro.

- Kemi vendosur pllakën me emrat e 15 maturantëve nga Komuna e Malishevës, të cilët janë aksidentuar në qytetin e Fushë Arrzit në Shqipëri, më 14 tetor të vitit 2004.
- Gjithashtu, kemi bërë kontratë për transportin e nxënësve me nevoja të veçanta;
- Po ashtu, kemi bërë kontrata për shërbime transportuese për nxënësit, të cilët vijojnë mësimet në SHFMU” Dëshmorët e Kombit” në Ngucat, SHFMU” Hasan Prishtina” në Tërpezë, dhe SHFMU” Ismet Jashari” në Temeqinë, nxënësve të lagjes Garaqevë për në SHFMU” AsimVokshi” në fshatin Panorc, SHFMU” 28 Nëntori” në Kërvasari. Po ashtu, edhe kontrata për bartjen e nxënësve në fshatin Janqist dhe Shkozë.

Gjatë vitit 2022, qeverisja jonë komunale e ka përkrahur çdo sektor të mundshëm të saj,

- Ka bërë subvencionimin e qumështit për 0.3. cent/litër, për të gjithë fermerët që dorëzojnë qumështin në pikat grumbulluese.
- Ka përkrahur të gjithë bletarët e komunës së Malishevës përmes pagesave direkte.

Gjithashtu,

- Kemi subvencionuar sportin, të gjitha klubet sportive, me theks të veçantë klubin e futbollit FC Malisheva, që garon në super ligën e Kosovës në futboll.
- Kemi subvencionuar organizatat e shoqërisë civile, nxënësit e mësimdhënësit të cilët kanë përfaqësuar institucionet e komunës sonë.



Në fund, kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, i ka uruar të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, me rastin e festave të fund vitit, si dhe është zotuar se do të vazhdoj të jetë i përkushtuar në realizimin e objektivave dhe synimeve për zhvillimin e përgjithshëm të Malishevës dhe realizimin e projektit për “Malishevën Urbane”. Përgjigje para qytetarëve dhanë edhe drejtorët e drejtorive ku u adresuan pyetjet si Urbanizmi, Shërbimet Publike, Arsimi etj.

Bajram Paçarizi- Rregullimi i disa lagjeve me kanalizim, largimi i mbeturinave dhe të sanksionohen hedhësit e paligjshëm në hapësirat publike, rrjeti i energjisë, të rriten subvencionet për serra dhe shtalla më shumë se me nga 1 ari hapësira , që të kemi zhvillim të qëndrueshëm.

Bashkim Gashi- Për funksionalizimin e rrugës Ibrahim Mazreku dhe të përfundimit të sajë.

Esheref Zogaj- Rregullimi i Trotuari, të krijohet mundësia e një ujëmbledhësi pasi fshati dhe relievi gjeografik e mundëson një gjë të tillë- kanalizim dhe fushë sportive për nxënësit e shkollës "Rifat Berisha".

Pjesa dërmuese e kryetarëve të fshatrave që morën pjesë në takim, kërkesat i kishin të njëjta me të parafolësve, kërkesa që ishin jo të parealizueshme pasi një pjesë e madhe e projekteve janë realizuar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës
Opština Malisevo/Municipality of Malisevo
Kryetari i Komunës
Njësia për Komunikim me Publikun



Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në takimin e dytë publik me qytetarë të kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ekrem Kastrati

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	AFRIM	MAZREKU	GURIA	Aktarullu
2	Enver	Berisha	Berishë	Enver
3	Enver	Maloku	Pilagice	Enver
4	Fadil	Yhalu	Ngucet	Fadil
5	VALMIR	GASHI	VERMICI	Valmir
6	Enver	Guri	Vermice	Enver
7	Enver	Yhalu	Bojce	Enver
8	Endrit	Berisha	Canadano	Endrit
9	Mehdi	Krasniqi	Caralluke	Mehdi
10	Shyret	Shyret	Lubizhde	Shyret
11	BASHKIM	BERISHA	GURBARO	Bashkim
12	Enver	Relueuol	Boline	Enver
13	Arrian	MORING	Atrozup	Arrian
14	Hoxhe	BOSTOL	Bublavec	Hoxhe
15	ESMA	GASHI	Balietce	Esma
16	NEHAT	KRAJNIA	DRENOC	Nehat
17	KUTIM	STOLLICA	Aligul	Kutim
18	BLERTA	KRASHI	DRENOC	Blerta
19	Shyret	MORING	Lubizhde	Shyret
20	BYRIM	GASHI	KRIVE	Byrim

Përgatiti: _____

Nënshkrimi: _____

Data: 23.12.2022